



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21X;22X.9-2013/15-08

RAPORT I AUDITIMIT
QASJA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE

Auditim jo i detyrueshëm

Prishtinë, Nëntor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Zëvendës-Auditori i Përgjithshëm, Artan Venhari është duke ushtruar detyrën e kreut të ZAP-it, që ka të punësuar rreth 145 anëtarë të stafit.

Misioni ynë është: “të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike”. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t’i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditimet e Performancës kryhen për të vlerësuar nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase si dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

Zëvendës-Auditori i Përgjithshëm, ka vendosur mbi këtë raport performance për “Qasja për personat me aftësi të kufizuar fizike”.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Mirlinda Ahmeti, mbështetur nga Labinot Sadiku (Udhëheqës ekipi) dhe Pleurat Isuf (Anëtar ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	i
Çka kemi audituar?	i
Çka kemi gjetur?	i
Çka rekomandojmë?.....	ii
1 Hyrje.....	1
Objektivi dhe pyetjet e auditimit	3
Kriteret e auditimit	3
Metodologjia, fushëveprimi dhe kufizimet e auditimit	4
Struktura e raportit.....	5
2 Legjislacioni dhe përgjegjësitë.....	6
Legjislacioni	6
Përgjegjësitë e nivelit qendror	7
Përgjegjësitë e komunave	7
3 A kanë ndërmarrë autoritetet lokale masa praktike për krijimin e një mjedisi të qasshëm për PAK dhe a kanë zhvilluar një sistem informativ mbi qasshmërinë i cili funksionon si duhet?.....	8
Çfarë është bërë në praktikë dhe cila është cilësia e masave të ndërmarra?	8
A kanë paraqitur autoritetet lokale sisteme informative në lidhje me qasshmërinë në infrastrukture fizike për PAKF?	17
4 A ka krijuar Qeveria mekanizma të duhur për monitorim, raportim dhe zbatim të Strategjisë?.....	19
Deri në çfarë mase janë këta mekanizma funksional?	19
A ekziston komunikim formal midis ZQM-së dhe institucioneve lokale dhe deri në çfarë mase?	20
A është ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me mangësitë eventuale?.....	20
5 Konkluzionet.....	21
6 Rekomandimet.....	23
Shtojca 1. Foto të hapsirave plotësisht, pjesërisht dhe aspak të qasshme.....	24

Lista e shkurtesave

PAK	Personat me Aftësi të Kufizuar
PAKF	Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
SKPAK	Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
KKPAK	Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
KMRV	Komisioni për Monitorim Raportim dhe Vlerësim
UA	Udhëzimi Administrativ
PK	Plani Kombëtar
OPAK	Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuar
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
OSH	Objekte Shkollore
DPU	Drejtoria për Planifikim Urban
GP	Grupi Punues
PKO	Plani Komunal Operativ

Përmbledhje e përgjithshme

Çka kemi audituar?

Në vitin 2013 Qeveria ka aprovuar “Strategjinë për Personat me Aftësi të Kufizuar” ku njëri prej qëllimeve është krijimi i një qasje më të mirë për Personat me Aftësi të Kufizuar. Është aprovuar Plani i Veprimit 2013-2023 i cili specifikon përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm publik në nivele qendror dhe lokal.

Ne kemi audituar nëse aktivitetet e ndërmarra nga akterët përgjegjës në “Strategjinë për Personat me Aftësi të Kufizuar” dhe Planin e Veprimit kanë qenë efektiv në krijimin e një qasje më të mirë fizike në Institucionet publike për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike. Ne kemi analizuar parakushtet e dala nga Strategjia dhe Plani i Veprimit nëse masat e ndërmarra janë:

- Bazuar në identifikimin dhe prioritizimin e nevojave për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike;
- Menaxhuar në mënyrë efektive dhe efikase; dhe
- Adresuar vështirësitë dhe shkaqet pas ngecjeve gjate implementimit.

Auditimi është fokusuar në përgjegjësitë e dy akterëve atij qendror dhe lokal, bazur në një studim mbi gjendjen aktuale të qasjes për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike në katër Komuna (Gjilan, Pejë, Prizren, Prishtinë). Autoritetet qendrore janë vlerësuar në aspektin e monitorimit, vlerësimit, raportimit dhe këshilldhënies.

Çka kemi gjetur?

Përkundër përpjekjeve për të përmirësuar qasjen në infrastrukturë fizike dhe hapsira për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike, rezultatet e tanishme janë të kufizuara.

Masat e ndërmarra në mënyrë të rastësishme dhe në mungesë të prioritizimit nuk i kanë zgjidhur problemet. Objektivat e parapara në Strategji dhe Plan të Veprimit janë përmbushur në masë të ulët. Indikatorët tregojnë se situata në këtë aspekt mund të jetë e ngjajshme edhe në komunat tjera.

Ngecjet e gjetura kanë ndodhur për arsye si më poshtë:

- Format e financimit në Strategji;
- Shumica e komunave nuk kanë arritur që të themelojnë grupe punuese për identifikimin e nevojave dhe vlerësimin e situatës si bazë për prioritizim;
- Komunat nuk kanë inkoorporuar qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në planifikimin strategjik;
- Komunat nuk kanë siguruar mjaftueshëm forma të brendshme apo të jashtme të financimit;
- Gjatë licencimit të ndërtimeve të reja (lejet e ndërtimit dhe certifikatat e banimit), nuk janë marrë parasysh kërkesat që dalin nga kornizat ligjore;

- Organizata në nivelin qendror nuk ka funksionuar siç është synuar. Mungesa e fokusimit dhe përcaktimit kur vie tek implementimi i detyrimeve, në kombinim me ndarjen e paqartë të përgjegjësi ndërmjet funksioneve të ndryshme ka krijuar një trajtim joefektiv të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike.

Çka rekomandojmë?

Praktikat e mira të aplikuara deri tani tregojnë se përmirësimi efektiv i qasjes fizike për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike mund të arrihet përmes një bashkëpunimi më të afërt ndërmjet Institucioneve përgjegjëse dhe me një angazhim më të përkushtuar në përmirësimin e gjendjes për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike.

Ne rekomandojmë Kryetarët e Komunave të:

- sigurojnë se planet operative komunale të bazuara në identifikim dhe prioritizim të nevojave janë hartuar, aprovuar dhe publikuar;
- ndërmarrin masa për të kërkuar burime alternative të financimit në përkrahje të projekteve që prekin qështjet lidhur me qasjen;
- sigurojnë se sistemi për licencimin e lejeve të ndërtimit është implementuar në përputhshmëri me kornizën ligjore;
- të vendosin një sistem informativ lidhur me qasjen në objekte dhe infrastrukturë, parkingje, etj; dhe
- vendosin një linjë telefonike ku Personat me Aftësi të Kufizuar mund të shprehin sugjerimet dhe ankesat e tyre.

Ne rekomandojmë Qeverinë që:

- strategjia kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Plani i Vperimit janë implementuar sipas parashikimeve;
- Zyra për Qeverisje të Mirë së bashku me palët e interes (Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Kryetarët e Komunave, Insitucionet relevante) kryejnë analiza rreth gjendjes aktuale dhe propozojnë masa që duhet ndërmarrë për të bërë reformat e duhura.
- Zyra për Qeverisje të Mirë vlerëson funksionalitetin e Këshillit dhe Komitetit, konsideron mundësinë e shkrirjes së tyre në një mekanizëm dhe vendos rregullat e punës;
- Zyra për Qeverisje të Mirë vendos Grupin Punues i cili do të ketë për detyrë ekzaminimin e masave të ndërmarrë dhe të verifikojë informatat e mbledhura nga Insitucionet përgjegjëse;
- Se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor merr në konsideratë parregullsitë lidhur me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të banimit të paraqitura në nivelin lokal dhe siguron se ato do të adresohen edhe nga niveli qendror për objektet që i përkasin kategorisë së tretë.

1 Hyrje

Ekziston një numër i konsiderueshëm i Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në botë. Të drejtat e tyre të plota dhe të barabarta për integrim në shoqëri duhet të mbrohen në përputhje me deklaratat ndërkombëtare dhe konventat¹ e nënshkruara. Në këto PAK-ët janë definuar si të gjithë personat që kanë dëmtime afatgjate fizike, mendore, intelektuale apo dëmtime në të dëgjuar të cilat mund ta kufizojnë trajtimin e tyre të barabartë në shoqëri. Hulumtimi i fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) tregon se 15% e popullsisë së botës ka një formë të caktuar të aftësisë së kufizuar.²

Strategjia Evropiane e Personave me Aftësi të Kufizuar 2010-2020 thekson³ se një në gjashtë persona në Bashkimin Evropian (BE) kanë një paaftësi e cila variron nga e buta në më të rëndë që përbëjnë rreth 80 milionë. Këta persona shpesh kufizohen të marrin pjesë plotësisht në shoqëri dhe ekonomi për shkak të barrierave në mjedis dhe në pikëpamje të shoqërisë. Shkalla e varfërisë për njerëzit me aftësi të kufizuar është 70% më e lartë se mesatarja, pjesërisht për shkak të qasjes së kufizuar në punësim. Strategjia e përmendur ka renditur tetë fusha⁴ kryesore për ndërmarrjen e veprimeve dhe qasja mbetet si prioritet i lartë.

Përveç kësaj, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015, thekson se PAK vazhdojnë të ballafaqohen me mbështetje joadekuate Institucionale dhe shëndetësore, dhe qasje të dobët.⁵

Në Kosovë, numri i përgjithshëm i PAK përafërsisht është 150,000 ose 7% e popullsisë⁶. Krahas kësaj, sipas të dhënave nga sondazhi i realizuar nga Zyra e Kryeministrit (Zyra për Qeverisje të Mirë, ZQM) tregon se përqindja e Personave me Aftësi të Kufizuar Fizike (PAKF) përbën numrin më të madh të PAK.

Qeveria ka miratuar një Strategji Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (SKPAK), si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e SKPAK (në tekstin e mëtejshëm PV). Strategjia i përmbahet dhe i garanton tetë parimet e përgjithshme të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e PAK-ëve. Njëra nga këto parime është pjesëmarrja e plotë dhe efektive dhe përfshirja e PAK-ëve në veprimet e përditshme të shoqërisë.

Objektivi i pestë strategjik parasheh krijimin e kushteve të barabarta për qasje, informata, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijim të një sistemi të unifikuar të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Qasshmëria është një nga fushat më problematike që duhet të përmirësohen, në mënyrë që të krijohet qasje më e mirë për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha aktivitetet e shoqërisë (arsim, shëndetësi, punë) etj.

¹ Karta e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, dhe të Konventave Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut përcakton parimet që njohin dinjitetin e qenësishëm dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme e të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore si themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.

² Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2022

³ Shih Hyrjen, paragrafi 1

⁴ Kapitulli 2, Objektivat dhe veprimet, paragrafi 2

⁵ Poaty, 2015, KE

⁶ Sondazh i gjerë mbi PAK në Kosovë 2011 (Zyra për Qeverisje të Mirë)

Aktualisht këto janë pengesa të mëdha, që pengojnë PAK-ët që të gëzojnë mundësitë e barabarta të cilat qytetarët tjerë i gëzojnë. Pengesat e tilla janë barrierat strukturore në ambientet e ndërtuara, mungesa e planifikimit urban, planifikimi joadekuat i ambienteve të brendshme etj.

PV është i bazuar në përshkrimin e situatës për PAK-ët dhe është i zërthyer sipas aktivitetit të paraparë, përfshirë: objektivat, indikatorët që do zhvillohen tutje, mjetet e verifikimit, institucionet përgjegjëse për implementim, institucionet mbështetëse, afatet kohore dhe një buxhet të përafërt për implementimin e secilit aktivitet.

Kostoja financiare e parashikuar për zbatimin e PV është €3,000.000. Për implementimin e objektivës strategjike numër 5, janë parashikuar përafërsisht 1,500,000.00€ (48% të shumës së përgjithshme). Shuma vjetore për implementimin e kësaj objektivë parashihet të jetë 500.000.00€. Ndarja e kësaj shume, do të duhet të sigurohet nga institucionet përgjegjëse për Implementim⁷.

Korniza ligjore për personat e cenueshëm social/ose me aftësi të kufizuar është përmirësuar. Ligji për Gjuhën e Shenjave (2013-2023)⁸, dhe Ligji për paraplegjikët dhe tetraplegjikët është miratuar.

Kushtet e jetesës të PAK në përgjithësi janë të dobëta, duke lënë shumë për të bërë⁹ në këtë drejtim. Pavarësisht gatishmërisë dhe vullnetit politik, problemet janë të shumta në fusha të ndryshme të jetës, si ato në infrastrukturën fizike, arsim, shëndetësi, punësim, të dhëna statistikore etj. Mungesa e objekteve shëndetësore, atyre të arsimit dhe infrastruktura fizike për PAKF e bën të vështirë për ta që të marrin pjesë plotësisht në shoqëri (për të realizuar objektivat e tyre). Pas aprovimit të Strategjisë, Qeveria ka ndërmarrë veprime për të trajtuar problemin e qasjes mirëpo të arriturat janë të kufizuara.

⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar fq. 4

⁸ Raporti i Progresit për Kosovën 2014 nga Komisioni Evropian, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, fq. 19

⁹ <http://www.kosovalive360.com/personat-me-aftësi-të-kufizuara-ndihen-të-diskriminuar.htm>

Objektivi dhe pyetjet e auditimit

Objektivi i këtij auditimi është që të vlerësohen efektet e masave të ndërmarra në kuadër të PV nga niveli qendror dhe ai lokal, për të krijuar kushte më të mira për qasje tek PAKF-ët. Qëllimi është që të jepen rekomandime relevante, për përmirësimin e zbatimit të Strategjisë.

Pyetjet e auditimit kanë qenë:

- 1. A kanë ndërmarrë autoritetet lokale masa praktike për krijimin e një mjedisi të qasshëm nga PAK dhe a kanë zhvilluar një sistem informativ mbi qasshmërinë i cili funksionon si duhet?**
- 2. A ka krijuar Qeveria mekanizma të duhur për monitorim, raportim dhe zbatim të Strategjisë?**

Kriteret e auditimit

Ne kemi analizuar performancën e nivelit qendror dhe të atij lokal kundrejt kriterëve të hartuara nga praktikatat më të mira ndërkombëtare, ligjeve, rregulloreve, udhëzuesve e politikave, etj. Kriteret e paraqitura më sipër janë krijuar për Qeverinë dhe nivelin komunal.

Qeveria duhet të krijojë dhe funksionalizojë mekanizma operacional që kanë të bëjnë me këshillimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin për implementimin e strategjisë. Kjo duhet të arrihet nëpërmes:

- Caktimit të Komisionit për Monitorim, Raportim dhe Vlerësim (KMRV) dhe Këshillit Kombëtar për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK). Këta mekanizma duhet të këshillojnë, monitorojnë, përcjellin dhe raportojnë mbi të arriturat dhe ngeçjet lidhur me PAK, në nivel qendror dhe lokal. Funksionaliteti i këtyre mekanizmave duhet të sigurohet përmes nxjerrjes së një rregulloreje të brendshme të punës e cila përcakton përgjegjësitë e këtyre mekanizmave.

Komunat duhet të marrin masa për të krijuar ambient të përshtatshëm për PAK. Për të arritur këtë ato duhet që të:

- Krijojnë Grupe Punuese (GP) për zhvillimin e Planeve Komunale Operative (PKO) në bazë të PV. GP duhet të përbehen nga anëtarë të departamenteve të ndryshme që janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe qasjes për PAK;
- PKO-të duhet të miratohen në kuvendet komunale dhe duhet të shërbejnë si mjet për:
 - Identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për qasje të PAK;
 - Specifikimin e projekteve të investimeve nga PV në infrastrukturë dhe ndërtesa private/ publike, në përputhje me objektivat dhe kornizën ligjore në fuqi;

- Sigurimin e fondeve, miratimin e buxhetit, kryerjen dhe monitorimin e zbatimit të projektit;
- Të raportojnë tek ZQM në afate të caktuara kohore lidhur me aktivitetet e realizuara;
- Drejtoritë për Planifikim Urban (DPU) duhet të lëshojnë leje ndërtimi dhe certifikata banimi; dhe
- Të zhvillojnë një sistem informativ mbi qasshmërinë në infrastrukturë apo objekte publike. Kjo mund të përfshijë faqe të internetit komunale lidhur me ambientet e qasshme, broshurave, shënjimin dhe sinjalizimin, linjat telefonike, etj.

Metodologjia, fushëveprimi dhe kufizimet e auditimit

Në këtë auditim ne jemi fokusuar në PAKF, pasi që kjo shtresë përfaqëson numrin më të madh të PAK-ëve¹⁰. Për më tepër, ne kemi trajtuar përgjegjësitë kur është fjala për krijimin e parakushteve për PAK-ët dhe kemi analizuar shkaqet e ritmit dukshëm të ulët në implementimin e PV.

Ne kemi përdorur një numër metodash në mënyrë që të jepen përgjigje për pyetjet e auditimit. Gjatë procesit të auditimit ne kemi:

- Analizuar SKPAK, duke adresuar çështjet e rëndësisë më të lartë që kanë të bëjnë me temën e auditimit;
- Analizuar PV;
- Analizuar PKO;
- Kemi kryer intervista me akterët kompetent;
- Kemi observuar dhe analizuar ndërmarrjen e masave praktike, si:
 - masat konkrete të ndërmarra nga komunat (arsyeshmërisë dhe nëse janë kryer dhe bazuar në analizimin e nevojave),
 - planet e prokurimit që mbulojnë trotuaret, shkollat, spitalet (ambulancat), institucionet publike dhe infrastrukturën.

Përveç kësaj, ne kemi kryer observime në terren të objekteve (të arsimit, shëndetësisë, publike dhe të infrastrukturës), në mënyrë që të sigurohemi se a janë ndërtuar në mënyrë të përdorshme për PAKF-ët apo jo.

Subjektet e audituara kanë qenë ZQM dhe katër komunat e mëposhtme të përzgjedhura si mostra: Gjlani, Peja, Prizreni, dhe Prishtina.

Gjlani është përzgjedhur si mostër pasi që ka përfituar dhe ka implementuar një projekt, donacion i Ambasadës Italiane për përmirësimin e objekteve dhe infrastrukturës. Komunat tjera janë

¹⁰ Shih hyrjen e këtij raporti, paragrafi 2, fq. 1

përzgjedhur për shkak të numrit të lartë të PAKF-ëve, në krahasim me numrin e përgjithshëm të qytetarëve.

Ne jemi fokusuar në shkolla, spitale, objekte publike dhe në infrastrukturë. Ne kemi konsideruar se PAKF-ët, varësisht prej moshës, kryesisht kanë nevojë për kushte dhe shërbime që ndërlidhen me to.

Auditimi mbulon periudhën 2013-2015.

Struktura e raportit

Raporti më tutje trajton kapitujt si më poshtë:

Kapitulli 2: Legjislacioni dhe përgjegjësitë;

Kapitulli 3: A kanë ndërmarrë autoritetet lokale masa praktike për krijimin e një mjedisi të qasshëm nga PAK dhe a kanë zhvilluar një sistem informativ mbi qasshmërinë i cili funksionon si duhet?

Kapitulli 4: A ka themeluar Qeveria mekanizmat e duhur për Monitorim, Raportim, dhe Implementim të Strategjisë?

Kapitulli 5: Konkluzionet; dhe

Kapitulli 6: Rekomandimet.

2 Legjislacioni dhe përgjegjësitë

Legjislacioni

Ligji për Ndërtime (LN) nr. 04/L-110 klasifikon ndërtimet në tri kategori¹¹. Kategoria e parë dhe e dytë e objekteve janë përgjegjësi e nivelit lokal ndërsa kategoria e tretë përfshirë objektet me rrezikshmëri të lartë janë nën përgjegjësinë e nivelit qendror.

Niveli lokal është përgjegjës për ndërtesa si shkollat, spitalet, institucionet tjera publike¹².

Për qëllim të këtij auditimi, janë dy aspekte që do të trajtohen kur është fjala për LN, që kanë të bëjnë me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të banimit.

Leja e ndërtimit lëshohet kur organi kompetent ka kontrolluar nëse aplikuesi për leje ndërtimi ka marrë në konsideratë kriteret që dalin nga LN dhe Udhëzimet Administrative (UA-të).

Sipas LN-së¹³, pasi të jenë kryer punimet nga ndërtuesi, organi kompetent lëshon certifikatën e banimit që është dokument verifikues i cili dëshmon se ndërtesa (objekti) është në përputhje me dokumentet e ndërtimit, dhe është në një gjendje të përshtatshme për banim. Pranimi teknik i ndërtesës është aktivitet i cili kryhet para se të lëshohet certifikata e banimit. Pranimi teknik i objekteve duhet të kryhet duke marrë parasysh: qëndrueshmërinë mekanike dhe stabilitetin, mbrojtjen nga zjarri, kursimet e energjisë, mbrojtjen nga temperatura, mbrojtjen nga zhurma.¹⁴

Prandaj, lidhur me atë që u përmend më lart, UA për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, nr. 33/7 siguron kriteret për ndërtimin e objekteve të reja dhe modernizimin e atyre të vjetra.

¹¹ Ky ligj përcakton dispozitat që rregullojnë lëshimin e lejes së ndërtimit, përputhshmërinë me kërkesat e lejes së ndërtimit dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ligji parashihet tri kategori të ndërtimeve: Kategoria I - Objektet me rrezik të ulët; Kategoria II - Objektet me rrezik të mesëm, kategoria III - Objektet me rrezik të lartë dhe interes kombëtar. Për dy kategoritë e para, Komuna është përgjegjës për lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatat banimit, ndërsa për kategorinë e tretë kjo përgjegjësi i takon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pasi që ato janë me interes kombëtar siç përshkruhet në Shtojcën 1 të LN-së

¹² UA Nr. 09/2013 mbi kategorizimin e punimeve të ndërtimit, neni 4 dhe 5

¹³ Neni 3, paragrafi 1.19

¹⁴ Ligji Nr. 2004/15, Kapitulli 2, Kërkesat bazike për ndërtim

Përgjegjësitë e nivelit qendror

SKPAK, paraqet bazën për krijimin e mekanizmave për implementim, monitorim dhe raportim. Këta mekanizma përfshijnë nivelin qendror dhe atë lokal.

Në nivelin qendror, pronari i strategjisë është ZQM. Dy mekanizmat¹⁵ janë të krijuar nga ZQM e që janë përgjegjës për monitorim dhe raportim, vlerësim dhe këshillim:

1. **Këshilli Kombëtar i PAK-ve** duhet të përcjellë monitorimin dhe të rishikojë kushtet e jetesës për PAK-ët dhe të njëjtën kohë ta këshillojë Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve më të mira të jetesës për PAK-ët.
2. **Komisioni për Monitorim, Raportim dhe Vlerësim** të implementimit të strategjisë duhet të menaxhohet nga ZQM-ja. Ky Komision do të mbajë takime të rregullta për ta monitoruar tërë procesin e implementimit të strategjisë dhe PKO-ve.

Përgjegjësitë e komunave

Komunat janë përgjegjëse për implementimin e ligjeve dhe UA-ve. Ato gjithashtu janë përgjegjëse për zhvillimin e PKO për implementimin e SKAPK, që do të aprovohet në Kuvendin Komunal.

Sipas PV, komunat duhet të ndërmarrin aktivitete të caktuara që ndërlidhen me objektivin e pestë të strategjisë. Aktivitetet janë të parapara që të orientohen drejt:

- Zhvillimit të hulumtimeve në nivelin lokal për PAKF;
- Hulumtimin për qasjen e institucioneve shëndetësore për PAKF;
- Ndërtimit dhe funksionalizimin të rampave për qasje me pjerrtësi (maksimum 6% sipas standardeve) dhe tualete me standarde për PAKF në objektet shëndetësore publike;
- Përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës parashkolllore dhe universitare për PAKF; dhe
- Përmirësimin dhe përshtatshmërinë e infrastrukturës në stacione të autobusëve, stacione hekurudhore, aeroporte dhe vend ndaljet për autobusë.

DPU është përgjegjëse për dhënien e lejes së ndërtimit, si dhe për verifikimin nëse objektet e ndërtuara i plotësojnë kushtet që parashihen në ligjet dhe rregulloret në fuqi duke konfirmuar këtë nëpërmes lëshimit të certifikatës për banim.¹⁶

¹⁵ Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023, fq.20

¹⁶ Ligji mbi Ndërtimin Nr. 04/L-110, neni 27

3 A kanë ndërmarrë autoritetet lokale masa praktike për krijimin e një mjedisi të qasshëm për PAK dhe a kanë zhvilluar një sistem informativ mbi qasshmërinë i cili funksionon si duhet?

Çfarë është bërë në praktikë dhe cila është cilësia e masave të ndërmarra?

PKO dhe parashikimi i financimit të aktiviteteve

Për të arritur krijimin e një ambienti të qasshëm për PAKF, nivelet lokale duhet të vendosin Grupe Punuese (GP) që duhet të përcaktohen me vendime të veçanta. GP-të duhet të hartojnë PKO-të në të cilat përcaktohen: ndarjet buxhetore, prioritetet për përmirësimin e infrastrukturës, incizimi i qytetit duke identifikuar pikat kyçe që mundësojnë qasje nëpër objekte dhe infrastrukturë. Krijimi i këtyre planeve sipas identifikimit të nevojave dhe bazuar në vlerësimin e tyre duhet të prezantohet tek donatorët e ndryshëm për të kërkuar financime.

Komuna e Gjilanit për hartimin e PKO kishte vendosur një GP prej nëntë anëtarësh i përbërë nga drejtoritë e ndryshme brenda komunës. Ky GP po ashtu ka hartuar edhe rregulloren e punës. Të gjitha Drejtoritë kanë hartuar planet e tyre. Drejtoria e Shëndetësisë e ka hartuar planin dhe këtë e ka kaluar në komitetin e shëndetësisë duke e bërë final. Drejtoritë tjera si ajo e Planifikimit Urban, Arsimit dhe Shërbimeve Publike kanë hartuar planet e tyre por nuk i kanë finalizuar ato. Kjo do të thotë se përkundër përpjekjeve, Gjilani nuk ka arritur të hartojë një plan final për PAK dhe të përcjellë atë në Kuvendin Komunal për miratim.

DPU në kuadër të Pejës, për të pasur njohuri për pengesat që hasin kategoria e PAKF, ka iniciuar themelimin e një GP për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për qasje nëpër trotuare, objekte shkollore si dhe objekte arsimore. DPU ka hartuar një raport për ta përcjellë në Drejtorinë e Arsimit në mënyrë që ta mbajë të informuar këtë drejtori lidhur me qasjen nëpër objekte arsimore për PAKF. Më pastaj ka synuar që të marrë informata shtesë nga kjo drejtori për qasjen nëpër objekte shkollore të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë në kemi kërkuar këtë raport, Drejtoria në fjalë nuk ka arritur të na ofroj atë.

DPU në kuadër të Prishtinës në fund të vitit 2014 ka themeluar një GP për identifikimin e pikave kyçe për qasje në infrastrukturën rrugore të Qytetit. Gjatë auditimit kemi vërejtur se ata kanë arritur që të hartojnë një raport duke prioritetizuar rëniet nga trotuaret dhe vendkalimet në Qytet. Mirëpo kjo mbetet vetëm ide sepse nuk është mbështetur me ndonjë dokument për ta vërtetuar atë.

Pavarësisht se DPU-të në kuadër të komunës së Pejës dhe Prishtinës, kanë marrë hapa për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për PAKF, këto nuk janë bërë duke u bazuar në SKPAK as në PV. Këto të dhëna mund të përdoren në të ardhmen kur komunat përkatëse do të nisnin procesin për hartimin e PKO-ve.

Për dallim nga Komuna e lartpërmendur, Prizreni nuk ka arritur të krijojë GP të cilët dalin si kërkesë nga PV dhe njëkohësisht nuk ka hartuar PKO.

Ndërsa sa i përket financimit të Strategjisë, në PV është paraparë që mjetet financiare të sigurohen nga buxheti i Qeverisë, të hyrat vetanake të komunave si dhe nga donacionet e ndryshme.

Nuk është aranzhuar asnjë kontribut nga donatorët e as financim nga qeveria me përjashtim të Gjilanit e cila në periudhën (para aprovimit të strategjisë) ka siguruar një mbështetje. Më tutje, asnjë komunë, përfshirë edhe atë të Gjilanit nuk kanë bërë ndarje buxhetore për krijimin e qasjes për PAKF.

Lëshimi i lejeve për ndërtim dhe certifikatat e banimit

DPU e Komunës përkatëse është e obliguar që aplikuesit t'i lëshojë leje për ndërtim, përfshirë edhe certifikatën për banim. Leja e ndërtimit lëshohet vetëm nëse aplikuesi i ka përmbushur kërkesat e parashtruara në LN. Certifikatat e banimit duhet të lëshohen pas kryerjes së ndërtimit nëse ndërtimet janë bërë në pajtim me rregulloret e parapara në lejet për ndërtim.

Gjilani gjatë periudhës 2013-2015, nuk ka lëshuar leje të ndërtimit për objekte publike dhe private. Nga DPU kemi kërkuar raporte që dëshmojnë dhënien e lejeve për ndërtim, mirëpo nuk kanë arritur që të ofrojnë dëshmi për këtë.

E njëjta situatë është hasur edhe në Prishtinë. Gjatë intervistës me Kreun e DPU në Prishtinë neve na është thënë se gjatë vitit 2014-2015 zyrtarët përgjegjës komunal me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve për leje të ndërtimit, marrin parasysh kriteret si: hapësira gjelbëruese, pjerrinat dhe parkingjet. Sidoqoftë kjo informatë mbetet e mbështetur vetëm nëpërmes intervistës por jo edhe me ndonjë dokumentacion tjetër si dëshmi relevante.

Situata dallon kur marrim parasysh Prizrenin dhe Pejën. Në Prizren gjatë viteve 2013-2014 janë lëshuar katër leje për objekte publike, një për Qendrën për Mjekësi Familjare (QMF) dhe tri për shkolla. Lejet e ndërtimit të lëshuara nga kjo Drejtori janë bërë në përputhje me LN. Në Pejë kemi gjetur se janë lëshuar dy leje po ashtu në përputhje me Ligjin. Megjithatë, një tjetër kusht për lëshimin e lejeve të ndërtimit duhet të jetë edhe UA¹⁷ mbi kushtet teknike për ndërtimin e ndërtesave, i cili nuk është marrë në konsideratë me rastin e dhënies së lejeve të ndërtimit.

Asnjëra nga komunat nuk kanë arritur të dëshmojë se janë lëshuar certifikata të banimit dhe kjo nënkupton se nuk është kryer asnjë pranim teknik i objekteve.

Masat e ndërmarra

Në këtë pjesë kemi shqyrtuar masat e ndërmarra nga komunat për të krijuar një mjedis të qasshëm për PAKF. Ne kemi testuar se sa janë të shfrytëzueshme investimet e bëra në shkolla dhe objekte

¹⁷ UA nr. 33/07 Kushtet Teknike të Objekteve për Qasshmëri nga Personat me Aftësi të Kufizuara

shëndetësore. Në kuadër të tyre në kemi ekzaminuar pjerrinat, tualetet dhe sportelet si dhe qasjen nga trotuaret në këto objekte.

Tabela 1. Përmbledhja e qasshmërisë në objekte

	Gjilan	Prizren	Pejë	Prishtinë	Gjithsej
Plotësisht	25	28	13	22	88
Pjesërisht	2	1	3	4	10
Aspak	14	10	22	18	64
Gjithsej	41	39	38	44	162

Tabela e mësipërme paraqet gjendjen e objekteve të ekzaminuara dhe mundësinë që ato ofrojnë për qasje: të plotë, të pjeshme, apo aspak të qashme.¹⁸ Në fakt dy kategoritë e fundit kanë pak dallim nga njëra tjetra meqenëse në realitet asnjëra prej tyre nuk i përmbush plotësisht kushtet për qasje për PAKF. Duke u nisur nga kjo ne kemi gjetur se 54% e tyre i plotësojnë kushtet për PAKF, 6% pjesërisht dhe 40% aspak.

Më poshtë kemi prezantuar të gjeturat për secilën komunë e cila ishte pjesë e auditimit lidhur me qasjen në infrastrukturë dhe objektet të ndryshme publike. Tabelat e mëposhtme përshkruajnë elementet kryesore për qasje nëpër Komuna.

Infrastruktura e jashtme rrugore (trotuaret) dhe ajo brenda objekteve të ndryshme publike janë vlerësuar si më të rëndësishmet që sigurojnë qasje për PAKF dhe është bërë ekzaminimi i tyre.

Gjilani

Gjilani është i vetmi autoritet lokal i cili deri në këtë fazë ka arritur të siguroj donacione¹⁹. Rezultatet janë krijimi i një GP i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit kanë bërë vlerësimin e nevojave me qëllim të intervenimit në modernizimin e disa objekteve arsimore siç janë: dy kopshte, dy shkolla fillore, një gjimnaz, një shkollë e mesme teknike për ekonomi dhe shkolla e muzikës.

Krahas kësaj, në këtë projekt është bërë edhe modernizimi i disa objekteve tjera publike siç është Teatri i Qytetit. Bazuar në ekzaminimet e realizuara, mund të përfundojmë se të gjitha objektet të cilat janë modernizuar përgjatë implementimit të këtij projekti janë përshtatur kushteve teknike bazuar në UA²⁰.

¹⁸ Në shtojcën 1 kemi paraqitur disa fotografi duke treguar raste të objekteve plotësisht, pjesërisht apo aspak të qashme. Fotografitë janë marrë nga ekipi i auditimit gjatë ekzaminimeve në terren.

¹⁹ Donacion nga Bashkëpunimi Italian, financuar nga Ambasada Italiane

²⁰ U/A 33/07 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

Foto 1. Pjerrina e modernizuar nga projekti i realizuar në shkollën fillore “Thimi Mitko” në Gjilan



Fotoja lartë tregon një objekt të financuar nga Ambasada Italiane në Gjiçan.

Gjiçani pas implementimit të Projektit të financuar nga Ambasada italiane, nuk ka arritur që të përmirësojë më tutje qasjen në infrastrukturën rrugore dhe nëpër objekte.

Gjiçani ka 21 QMF dhe dy Qendra mobile.

Tabela 2. Qasshmëria në pjerrina (rampa), tualete, sportele nëpër QMF dhe Ambulanca

Gjiçan	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
QMF dhe Ambulanca	23	5	/	/	/
Pjerrina		5	3	/	2
Tualete		5	/	/	5
Sportele		5	5	/	/
Qasja nga trotuari		5	3	/	5

Ne kemi vërejtur se objektet shëndetësore duke filluar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat tjera dhe Ambulanat në përgjithësi nuk ofrojnë qasje fizike për PAKF. Gjatë ekzaminimit në pesë QMF-të kemi gjetur se tre nga to ofrojnë qasje apo hyrje të kënaqshme

përmes pjerrinave apo rampave në objekt për PAKF. Dy të tjera të cilat edhe pse kanë pjerrina, janë jofunksionale dhe të paqasshme nga PAKF.²¹

Sportelet - për tu qasur në shërbime brenda objektit, ato ofrojnë qasje duke përfshirë pesë QMF-të e zgjedhura për ekzaminim nga 21 gjithsej.

Në një numër të madh të QMF-ve, katet e sipërme të objektit janë të paqashme pasi që nuk kanë ashensorë ose shkallë lëvizëse. Një sërë shërbimesh ndodhen në katet e sipërme si shërbimi pediatrik, shërbimi stomatologjisë etj. Ne gjithashtu kemi gjetur se tualetet brenda objekteve të QMF-ve të ekzaminuara nuk janë të qasshme nga PAKF. Kushtet teknike përcjellëse brenda këtyre tualeteve nuk mundësojnë qasje për PAKF.²²

Gjilani ka 36 objekte shkollore në total. 25 janë shkolla fillore, 8 të mesme dhe 3 institucione parashkollore.

Analiza e ndërtesave shkollore është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Qasshmëria në trotuare, pjerrina (rampa), tualete nëpër objektet shkollore

Gjilan	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Objekte Shkollore	36	7	/	/	/
Pjerrina		7	4	2	1
Tualete		7	5	/	2
Qasja nga trotuari		7	5	/	2

Ne kemi ekzaminuar 7 objekte shkollore, 4 objekte të shkollave fillore, 2 objekte të shkollave të mesme dhe një institucion parashkollor.

Në institucionin parashkollor kemi gjetur se qasja në trotuar nuk është e mundshme për arsye të lartësisë së trotuarit. Infrastruktura përcjellëse nga trotuari deri në objekt mundëson lëvizshmëri pa pengesa për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në objektet e shkollave fillore të analizuara kemi gjetur se të gjitha këto ofrojnë qasje për PAKF. Të dyja këto projekte të analizuara ishin mbështetur nga donacioni i Ambasadës Italiane. Kur është fjala për dy objektet e shkollave të mesme, ne kemi vërejtur se edhe pse njëra shkollë është e përfshirë në këtë projekt, qasshmëria e ofruar ishte e pjesshme. Ajo ofron qasje nga rruga deri në objekt, mirëpo nuk ka tualete të qasshme. Objekti tjetër shkollor nuk ofron as kushtet elementare për qasje për nxënësit me aftësi të kufizuara.²³

²¹ U/A 33/07, Neni 10 (Me jo-funksionalitet nënkuptohet që rampa nuk ka pjerrtësinë e duhur 1:20 (5%) dhe gjerësinë në hapësirat e jashtme deri në 120 cm, përderisa hapësira e brendshme duhet të jetë 90 cm. Të ndërtohet rampa që të mos jetë e ndryshme ndaj ndryshimeve termike dhe elemente tjera përcjellëse si dorezat mbajtëse etj.)

²² U/A 33/07, Neni 19

²³ Kushte elementare për qasje nënkuptohen qasja në objekte, rampa (pjerrina), ashensori për katet e sipërme, tualete, hapësirat e mjaftueshme brenda objektit shkollor.

Trotuaret dhe vendkalimet e këmbësorëve të cilat janë punuar gjatë tri viteve të fundit në Gjilan janë përshtatur kushteve teknike për qasje të PAKF. Në anën tjetër, vendkalimet tjera të cilat nuk kanë qenë pjesë e këtyre punimeve nuk përmbushin kushtet teknike.

Prizreni

Prizreni ka gjithsej 44 institucione shëndetësore. Institucionet shëndetësore përbëhen nga një QKMF, 14 QMF, 20 Ambulanca dhe një Qendër Emergjente.

Tabela 4. Qasshmëria në pjerrina (rampa), tualete, sportele nëpër QMF dhe Ambulanca

Prizren	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
QMF dhe Ambulanca	44	6	/	/	/
Pjerrina		6	6	/	/
Tualete		6	1	/	5
Sportele		6	6	/	/
Qasja nga trotuari		6	5	/	1

Është bërë ekzaminimi fizik i QKMF-së, katër QMF-ve, dhe Shërbimit të Urgjencës ku kemi konstatuar se QMF-të në Prizren kanë pjerrina që ofrojnë qasje për PAKF. Hapësira brenda objektit gjithashtu mundëson lëvizshmëri të mjaftueshme. PAKF kanë qasje në sportele dhe tualete. Katër QMF-të ofrojnë qasje në objekt në mënyrë të kënaqshme, përfshirë lëvizshmërinë brenda objektit, si dhe mundësojnë qasje në sportele për PAKF, ndërsa dy prej QMF-ve nuk kanë tualete. Objekti i Urgjencës në Prizren i plotëson të gjitha kushtet për PAKF. Për më tutje, as QKMF dhe as ndonjëra nga QMF-të nuk kanë ashensorë ose shkallë lëvizëse të cilat mundësojnë qasje në katet e sipërme. Për këtë vit është paraparë ndërtimi i një ashensori në QKMF si dhe një në QMF-1 për të krijuar qasje në katet e sipërme.

Gjatë përshtatjes së kushteve teknike për qasje në të gjitha objektet e përmendura, ato nuk janë bërë bazuar në UA për kushtet teknike ndërtimore për qasjen e PAKF. Objektet e ekzaminuara përkundër asaj që janë të pajisura me pjerrina edhe pse ato janë të qasshme, elementet tjera përcjellëse të rampës në këtë rast, si dorëzat mbajtëse nuk janë të vendosura që do të thotë se nuk janë plotësisht të qasshme.

Ne kemi gjetur se mungon shënjimi në shumicën e Objekteve Shëndetësore ku tualetet janë të qasshme. Në QKMF kemi vërejtur që edhe pse është ndërtuar së fundmi, ajo në anën tjetër ofron qasje nga trotuaret në objekt dhe siguron hapësirë të mjaftueshme brenda objektit për PAKF. Mirëpo, në anën tjetër infrastruktura përcjellëse si tualetet dhe ashensorët për në katet lartë nuk mundësojnë qasjen për PAKF.

Kur bëhet fjalë për objektet shkollore, Prizreni ka 58 shkolla fillore dhe të mesme. Ne si mostër për auditim i kemi përzgjedhë 5 nga këto.

Tabela 5. Qasshmëria në trotuare, pjerrina (rampa), tualete nëpër objektet shkollore

Prizren	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Objekte Shkollore	58	5	/	/	/
Pjerrina		/	4	1	/
Tualete		/	2	/	3
Qasja nga trotuari		/	4	/	1

Gjithsej janë ekzaminuar katër objekte shkollore fillore. Dy nga këto janë në gjendje të mirë; pra kanë rampa të qasshme poashtu dhe tualete, ndërsa njëra ka edhe ashensorë. Dy shkollat tjera fillore të ekzaminuara kanë rampa te qasshme për hyrje në shkollë, mirëpo tualetet nuk i kanë të qasshme. Shkolla e mesme e ekzaminuar nuk i plotëson kushtet për PAK, për arsye se është një objekt i vjetruar, ndërsa objekti i ri është në ndërtim e sipër.

Siç shihet nga tabelat e mësipërme, trotuaret në Prizren mundësojnë qasje për PAKF në mënyrë të mjaftueshme.

Peja

Peja ka një QKMF, një Qendër Poliklinike të Stomatologjisë dhe njëzetë Ambulanca dhe QMF. Informatat e siguruara tregojnë se afërsisht 90% e qendrave mjekësore mundësojnë qasje për PAKF, përmes pjerrinave (rampave). Infrastruktura e brendshme e objekteve shëndetësore në këtë rast tualetet, nuk janë të qasshme deri në at masë nëse krahasohen me qasjen në hyrje të objektit. Në shumicën e qendrave mjekësore tualetet nuk janë të qasshme.

Tabela 5. Qasshmëria në pjerrina (rampa), tualete, sportele nëpër QMF dhe Ambulanca

Pejë	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
QMF dhe Ambulanca	22	5	/	/	/
Pjerrina		5	1	1	3
Tualete		5	/	/	5
Sportele		5	2	/	3
Qasja nga trotuari		5	4	/	1

Ne kemi ekzaminuar QKMF-në, Poliklinikën Stomatologjike, tri QMF-të dhe objektin shëndetësor i cili është duke u ndërtuar në fshatin Leshan. Nga ekzaminimi kemi gjetur se QKMF dhe dy QMF-të kanë rampa (pjerrina) të cilat plotësojnë pjesërisht kushtet për qasje. Në njërin QMF rampa është e punuar me material i cili nuk është kundër-rrëshqitës bazuar në UA²⁴ dhe nuk mundëson qasje të plotë për arsye të ndryshimeve termike. Në tjetrën QMF edhe pse ekziston rampa, ajo nuk i plotëson kushtet për arsye të pjerrtësisë mbi nivelin e lejuar²⁵. Poliklinika Stomatologjike dhe një QMF nuk kanë pjerrina apo rampa të cilat mundësojnë qasje në objekt. Ne kemi gjetur se projekti i objektit shëndetësor që është duke u ndërtuar në Leshan parasheh vetëm qasjen në objekt (pjerrina) ndërsa nuk parasheh tualetet e qasme për PAKF në kuadër të objektit.

Peja njëjtë si komunat e tjera ka disa objekte arsimore për nivele të ndryshme të arsimit: një institucion parashkollor, 26 shkolla fillore dhe gjashtë shkolla të mesme.

Tabela 7. Qasshmëria në trotuare, pjerrina (rampa), tualete nëpër objektet shkollore

Pejë	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Objekte Shkollore	33	6	/	/	/
Pjerrina		6	3	2	1
Tualete		6	/	/	6
Qasja nga trotuari		6	3	/	3

Në dy objektet e shkollave të mesme kemi gjetur se njëra ofron qasje në objekt përmes pjerrinës e cila iu është përshtatur plotësisht kushteve për shfrytëzim. Ndërsa në objektin tjetër shkollor pjerrina mundëson qasje të kufizuar për arsye se është e ndërtuar me material rrëshqitës i cili nuk është i shfrytëzueshëm gjatë ndryshimeve termike.

Në katër objektet e shkollave fillore, tri prej tyre ofrojnë qasje të plotë në objekt përmes pjerrinave, ndërsa në njërin objekt, pjerrina është mbi nivelin e lejuar të pjerrtësisë²⁶.

²⁴ UA për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, neni 10

²⁵ Njëjtë me fusnotën 13

²⁶ Njëjtë me fusnotën 13

Institucioni parashkollor ofron qasje në objekt përmes pjerrinës për persona me aftësi të kufizuar, ndërsa brenda objektit tualetet nuk janë të qasshme. Ne kemi gjetur se qasja nga trotuari për në objekte shkollore është e pamundur për arsye të lartësisë së trotuarit. Duke iu referuar informatave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe ekzaminimeve fizike të realizuara, ne kemi gjetur se nuk janë ndërmarrë iniciativa apo masa, qoftë ajo e bazuar në vlerësim të nevojave ose në baza Ad-hoc për të sanuar ose për të krijuar qasje nëpër trotuare dhe vendkalime të këmbësorëve.

Trotuaret ofrojnë pjesërisht qasje për PAKF.

Prishtina

Prishtina ka një QKMF, 14 QMF, 17 ambulanca dhe një shërbim emergjent. Në total ne kemi ekzaminuar 5 QMF.

Sa i përket objekteve arsimore, Prishtina ka 8 institucione parashkollore, 43 shkolla fillore dhe 13 shkolla të mesme. Nga këto ne kemi ekzaminuar 1 institucion parashkollor, 3 shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme.

Tabelat më poshtë paraqesin një pamje të detajuar në lidhje me ekzaminimet e kryera në objektet shëndetësore dhe arsimore.

Tabela 8. Qasshmëria në pjerrina (rampa), tualete, sportele nëpër QMF dhe Ambulanca

Prishtinë	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
QMF dhe Ambulanca	32	5	/	/	/
Pjerrina		5	2	2	1
Tualete		5	/	/	5
Sportele		5	2	2	1
Qasja nga trotuari		5	3	/	2

Nga pesë objekte shëndetësore të ekzaminuara, kemi gjetur se katër prej tyre ofrojnë qasje përmes pjerrinave. Dy nga këto objekte nuk i kanë përshtatur pjerrinat sipas standardeve të parapara. Njëra ka pjerrtësi më të madhe se sa që lejohet, ndërsa pjerrina tjetër është e ndërtuar me material të rrëshqitshëm e cila pamundëson shfrytëzimin e saj gjatë ndërrimeve termike. Dy pjerrina tjera iu janë përshtatur standardeve, ndërsa në një objekt shëndetësor nuk ofrohet qasje përmes pjerrinës. Tualetet në këto objekte shëndetësore janë të përshtatura sipas nevojave të PAKF-ve.

Tabela 8. Qasshmëria në trotuare, pjerrina (rampa), tualete nëpër objektet shkollore

Prishtinë	Gjithsej	Të ekzaminuara	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Objekte Shkollore	64	8	/	/	/
Pjerrina		8	6	/	2
Tualete		8	5	/	3
Qasja nga trotuari		8	4	/	4

Nga tetë objektet e ekzaminuara institucioni parashkollor ofron qasje nga trotuari për në objekt dhe mundëson qasje përmes pjerrinës e cila është konform standardeve të parapara me UA. Dy shkolla fillore të ekzaminuara nuk ofrojnë qasje adekuate nga trotuari për në oborr të shkollës, njëri objekt nuk ka pjerrinë e as tualete, ndërsa dy të tjera kanë pjerrina dhe tualete të parapara sipas standardeve për qasje. Vlen të potencohet se shkolla fillore "Model" ofron qasje përmes ashensorit për në katet lartë. Dy nga katër objektet e shkollave të mesme të ekzaminuara ofrojnë qasje nga trotuari për në oborr të shkollës sipas standardeve, ndërsa dy të tjera jo, tri kanë pjerrina ndërsa njëra nuk ka pjerrinë për qasje. Në anën tjetër, dy nga katër objekte shkollore kanë tualete të qasshme sipas standardeve për PAKF ndërsa dy të tjera nuk janë të qasshme.

Bazuar në tabelat e lartcekura, trotuaret ofrojnë qasje të pamjaftueshme për PAKF.

A kanë paraqitur autoritetet lokale sisteme informative në lidhje me qasshmërinë në infrastrukture fizike për PAKF?

Informimi mbi lëvizshmërinë dhe qasjen për PAKF është një element shtesë i rëndësishëm sa vet qasja.

Realizimi i një sistemi informativ dhe format tjera për informim përmes mediave, linjave telefonike në shërbim të PAKF-ve, etj. janë të nevojshme.

Ne kemi gjetur se Komunitat me përjashtim të disa vend parkingjeve të cilat janë të shënuara për PAKF nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të tillë informues. Ne gjithashtu kemi vërejtur se disa objekte të shënuara nuk e kanë arritur qëllimin pasi kushtet brenda këtyre objekteve nuk i kanë shërbyer nevojave të PAK-ve. Një nga rastet është paraqitur në fotot më poshtë.

Foto 2. E nxjerrë në Prizren, objekti i Shërbimit emergjent



4 A ka krijuar Qeveria mekanizma të duhur për monitorim, raportim dhe zbatim të Strategjisë?

Qeveria ka vendosur mekanizma të cilët janë përgjegjës për arritjen e objektivave që dalin nga PV: KKPAK dhe KMRV.

Ne kemi vlerësuar aktivitetet e këtyre mekanizmave dhe funksionalitetin e tyre për të arritur objektivat që lidhen me PAKF të cilët në numër përbëjnë pjesën më të madhe të PAK.

Deri në çfarë mase janë këta mekanizma funksional?

KKPAK është emëruar në vitin 2011. Komisioni ka mbajtur dy takime.

Takimi i parë u mbajt në nëntor të vitit 2013 dhe takimi i dytë në dhjetor të vitit 2014. Në takimin e parë ishin të pranishëm zyrtarë të institucioneve përkatëse, përfaqësuesit e PAKF; anëtarë nga ZQM dhe anëtarët e Komisionit Evropian. Qëllimi i këtij takimi ishte të identifikohen arritjet dhe pengesat e secilit institucion publik përgjegjës për përmirësimin e mënyrës së jetës për personat me aftësi të kufizuara.

Çështjet e ngritura në takimin e parë ishin: zhvillimi i UA-së për personat e verbër, rishikimi i skemës për PAK-të, licencimi i personave për ofrimin e shërbimeve për PAK, zbatimi i ligjit, trajnimi dhe rehabilitimi, nevoja për intensifikimin e mbledhjeve të Këshillit etj.

Dhe në takimin e dytë u diskutuan çështje të tilla si: buxhetimi për aktivitetet e planifikuara në vitin 2014, krijimi i ekipeve të vlerësimit për nevojat e PAK, përmirësimi i kriterëve për financimin e projekteve të ndryshme për OPAK, etj.

Një aspekt i rëndësishëm i cili vlen të përmendet është pjesëmarrja e komunave në këto takime. Edhe pse ata në një farë mënyre janë të përfaqësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ky përfaqësim është përgjithësuar dhe nuk adreson sfidat specifike të komunave dhe mundësitë e tejkalimit të tyre. Përfaqësuesi i Ministrisë theksoi projektin për përshtatjen e teknologjisë informative për përdorim nga PAK në disa komuna.

Në anën tjetër, KMRV është themeluar në vitin 2010 për zbatimin e PV 2009-2011. Për herë të parë, Komisioni ka mbajtur një takim në vitin 2014. Konkluzionet nga ky takim janë: përgatitja dhe plotësimi i matricës në lidhje me aktivitetet e zhvilluara për vitin 2014, miratimi i projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, raportimi i progresit në zbatimin e SKPAK, etj.

Takimi i dytë u mbajt në prill të vitit 2015. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të ZQM-së dhe ministrive të ndryshme. Konkluzionet e takimit ishin: organizimi i takimit për KKPAK, planifikimi për një takim të përbashkët të Zyrave Ligjore në kuadër të tri ministrive (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e

Shëndetësisë) për hartimin e UA-së për Ligjin për personat e verbër, Raportin e Progresit mbi zbatimin e PV 2013-2015 etj.

Përfaqësuesit e komunave nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga mbledhjet e mbajtura nga dy mekanizmat e përmendur më lartë. Rëndësia e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të komunave është thelbësore pasi komunat janë ekzekutues direkt të projekteve që krijojnë qasje më të mirë për njerëzit me aftësi të kufizuara në përgjithësi dhe në veçanti për PAKF-të. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në këto takime, qasja fizike dhe ajo në informata nuk është përmendur fare. Takimet janë mbajtur në baza Ad-hoc.

Një tjetër aspekt që vlen të përmendet është se puna e Këshillit dhe Komitetit nuk bazohet në asnjë rregullore të miratuar. Për shkak të mungesës së një rregullore të tillë, rolet dhe përgjegjësitë e këtyre dy mekanizmave nuk janë të përcaktuara qartë. Këto argumente vënë në pikëpyetje funksionimin e duhur të këtyre mekanizmave.

Ne nuk kemi vërejtur asnjë formë komunikimi ndërmjet këtyre mekanizmave dhe komunave.

A ekziston komunikim formal midis ZQM-së dhe institucioneve lokale dhe deri në çfarë mase?

ZQM ka mbajtur të informuar të gjitha Institucionet Publike për përgjegjësitë dhe obligimet e tyre për Implementimin e PV. Në vazhdimësi ajo ka njoftuar se autoritetet përgjegjëse janë të obliguara të hartojnë PKO. Më tutje, ZQM ka dërguar te secili institucion përgjegjës matricën e dalë nga Plani i Veprimit e cila specifikon detyrat dhe përgjegjësitë për implementim. Ne kemi gjetur se autoritetet përgjegjëse për zbatimin PV kanë raportuar për çdo objektive bazuar në matricë. Megjithatë, në raste të caktuara, bazuar në informacion dhe të dhënat mbi aktivitetet, institucionet nuk kanë raportuar për progresin e arritur. Të dhënat e atyre që kanë raportuar ishin ose jo të plota ose jo relevante për qëllimet e përcaktuara në Strategji.

A është ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me mangësitë eventuale?

Bazuar në raportet e lartpërmendura, ZQM ka përgatitur një raport vjetor i cili është përmbledhje e aktiviteteve të kryera nga nivelet qendrore dhe lokale. Prezantimi është bërë në korrik të vitit 2015. Raporti ka paraqitur pengesat dhe vështirësitë e hasura në zbatimin e PV. Edhe pse mangësitë dhe pengesat janë raportuar nga komunat, ZQM nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap konkret për t'i adresuar ato.

Siç u përmend më herët, Këshilli kishte ngritur disa qështje në lidhje me buxhetimin, nevojën për krijimin e një GP për identifikimin e nevojave të PAK, përmirësimin e kriterëve të financimit, etj. Megjithatë, ne nuk kemi vërejtur se është ndërmarrë ndonjë hap qoftë nga niveli qendror apo lokal për adresimin e këtyre qështjeve.

5 Konkluzionet

Në përgjithësi, nga institucionet që kemi analizuar ne mund të konkludojmë se veprimet e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse të nivelit lokal dhe qendror për përmirësimin e kushteve të jetesës së PAKF-ve nuk kanë qenë efikase dhe efektive.

Komunat

Disa nga Komunat kanë marrë iniciativë për themelimin e GP për hartimin e PKO-ve për PAK, mirëpo planet në këto katër komuna të audituara nuk janë finalizuar. Pavarësisht kësaj, Komunat kanë arritur që në një masë të caktuar të zhvillojnë aktivitete drejt krijimit të kushteve për PAKF.

Pavarësisht ngecjeve dhe mos vazhdimit të implementimit të Strategjisë dhe PV për PAK, pas përfundimit të Projektit të bashkëpunimit, Gjilani mund të cilësohet si model praktik për Komunat tjera për shkak se Gjilani ka arritur të themelojë GP për të identifikuar dhe për të bërë vlerësimin e nevojave për PAK. Ka hartuar PKO për realizimin e projektit dhe ka arritur të bëjë implementimin e projektit. Përvojat e implementimit të projektit në bashkëpunim me donatorin kanë krijuar kushte më të favorshme për PAKF-të në institucione të ndryshme publike.

Tri komunat tjera kanë punuar pjesërisht drejt krijimit të një ambienti të qasshëm për PAKF. Aktivitetet e tyre nuk janë bërë bazuar në planet punuese të cilat duhen të rrjedhin nga Strategjia dhe PV. Aktivitetet e tilla janë realizuar në baza Ad-hoc pa ndonjë vlerësim më afatgjatë strategjik. Gjithashtu nuk është kryer vlerësimi i nevojave për PAK.

Asnjë nga komunat nuk e ka ngritur çështjen e financimit të aktiviteteve që lidhen me PAKF-të, edhe pse Strategjia e trajton këtë aspekt shumë qartë dhe parasheh dy rrugë të financimit duke ndarë buxhet të veçantë dhe duke identifikuar dhe fituar donacione.

Lëshimi i lejeve të ndërtimit në përputhje me UA për kushtet teknike për ndërtim të ndërtesave për qasje të PAK-ve mbetet një çështje shumë e rëndësishme për tu adresuar nga DPU-të në kuadër të komunave. Në këtë drejtim, ky UA nuk është marrë në konsideratë.

Nuk është kryer asnjë pranim teknik për të vlerësuar nëse objekti i ndërtuar plotëson kushtet e parapara në lejen e ndërtimit. Kjo e vë në pikëpyetje sigurinë e objekteve që përdoren nga të gjithë njerëzit përfshirë edhe PAKF-të.

Nevoja për një sistem informativ mbi lëvizshmërinë në qytet dhe mbi qasjen nëpër objekte është element i rëndësishëm i cili kontribuon në përmirësimin e jetës së PAKF. Gjetjet tona tregojnë se Komunat kanë dështuar në krijimin e një sistemi të tillë. Mungesa e krijimit të një sistemi informativ qoftë ai përmes internetit, mediave apo broshurave dhe formave tjera jo edhe aq të kushtueshme për Komunat është pengesë për zhvillimin e aktiviteteve të përditshme për PAKF.

Nuk ka linjë telefonike në shërbim të PAKF, dhe si rrjedhojë ata nuk mund të marrin informata të ndryshme e më konkretisht për qasjen dhe infrastrukturën e shfrytëzueshme nëpër qytete. Kjo

linjë mund të shfrytëzohet njëkohësisht edhe si mundësi për PAKF për të shprehur pakënaqësitë eventuale dhe sugjerime e tyre.

Qeveria

ZQM ka arritur të themeloj dy mekanizmat përgjegjës për Implementimin e Strategjisë dhe PV për PAK mirëpo përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk janë qartë të përcaktuara dhe kjo mund të rezultojë me dyfishimin e punës nga ana e këtyre mekanizmave duke pasur ndikim në arritjen e objektivave të synuara.

Dy mekanizmat nuk kanë vendosur forma të qarta të komunikimit me nivelin lokal dhe si rezultat i kësaj, Komunitatet kanë mbetur të painformuara lidhur me rezultatet e dalës nga këto takime.

Aktivitetet e zhvilluara nga Institucionet përgjegjëse dhe raportimet e tyre lidhur me të arriturat dhe ngeçjet, janë përcjellë dhe vlerësuar nga ZQM. Mirëpo, nuk janë marrë vendime konkrete drejt zgjidhjes së këtyre ngeçjeve as sa i përket raportimit e as kur bëhet fjalë për rezultate.

Edhe pse në mbledhjet e këshillit është përmendur çështja e financimit, nuk janë ndërmarrë aktivitete konkrete për gjetjen e modaliteteve të financimit.

6 Rekomandimet

Ne rekomandojmë Kryetarët e Komunave që:

- Të krijojnë GP-të të dala nga PV për Implementimin e Strategjisë për PAK;
- Të hartojnë PKO-të, duke identifikuar, vlerësuar dhe prioritizuar nevojat e PAK dhe ato ti aprovojnë në kuvende komunale;
- Gjatë planifikimit të buxhetit komunal, të konsiderohen nevojat për përmirësimin e qasjes në infrastrukturë fizike dhe objekte në kuadër të linjës së veçantë buxhetore;
- Të luajnë një rol aktiv drejt gjetjes së formave alternative të financimit sikur që janë donacionet, që të financojnë projektet që dalin nga PKO-të;
- Lejet e ndërtimit të lëshuara nga DPU, për ndërtesat publike dhe të tjera të kategorisë së parë dhe të dytë të jenë në përputhje me ligjet në fuqi dhe UA që përcakton specifikimet teknike të ndërtimit për PAK;
- Para lëshimit të certifikatave të banimit të sigurojë se është kryer pranimi teknik i një objekti të caktuar dhe ai plotëson kushtet e parapara në lejen e ndërtimit;
- Të vendosin një sistem informativ ku PAK do të kenë qasje në informata me interes për ta si: qasja nëpër objekte dhe infrastrukturë, parkingje; dhe
- Të krijojnë një linje telefonike për PAK, ku ata do të mund të shprehnin ankesat dhe sugjerimet e tyre eventuale.

Ne rekomandojmë Qeverinë që të sigurojë:

- Se ZQM së bashku me palët e interesuara (OPAK, kryetarët e komunave, institucionet relevante) të organizojnë takime të përbashkëta ku do të diskutohej situata aktuale, hapat që duhet ndërmarrë dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre;
- Se ZQM vlerëson funksionalitetin e Këshillit dhe Komitetit, rishikon vendimin e themelimit të tyre, mundësinë e shkrirjes së tyre në një mekanizëm të vetëm dhe krijimin e një rregullore të punës;
- Se ZQM do të krijojë një GP funksional për zbatimin e strategjisë, e cili do të ekzaminojë punët e kryera dhe verifikojë të dhënat e marra nga institucionet përgjegjëse;
- Se hapa konkret do të ndërmerren drejt përmirësimit të pengesave të raportuara nga institucionet publike;
- Parashikimin dhe ndërmarrjen e hapave konkret për financimin e zbatimit të SKPAK dhe PV;
- Se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr në konsideratë parregullsitë lidhur me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të banimit të paraqitura në nivelin lokal dhe siguron se ato do të adresohen edhe nga niveli qendror për objektet që i përkasin kategorisë së tretë.

Shtojca 1. Foto të hapsirave plotësisht, pjesërisht dhe aspak të qasshme

